



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË

Bordi

VENDIM

Nr. 45, Datë 07.03.2018

MBI

FILLIMIN E PROCEDURËS PËR MIRATIMIN E “RREGULLAVE PËR KUSHTET E SHËRBIMIT TË FURNIZIMIT ME ENERGJI ELEKTRIKE NGA FURNIZUESI I MUNDËSISË SË FUNDIT, DHE KUSHTET KONTRAKTORE TE FURNIZIMIT”.

Në mbështetje të neneve 16 dhe 87 të Ligjit nr. 43/2015 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”, neneve 19, pika 1, gërma “f” dhe 26 të “Rregullores për Organizimin, Funksionimin dhe Procedurat e ERE”, miratuar me Vendimin e Bordit të ERE nr. 96, datë 17.06.2016”; Bordi i ERE në mbledhjen e tij të datës 07.03.2018, mbasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga Drejtoritë Teknike mbi fillimin e procedurës për miratimin e “Rregullave për Kushtet e shërbimit të furnizimit me energji elektrike nga furnizuesi i mundësisë së fundit, dhe kushtet kontraktore të furnizimit”,

Konstatoi se:

- Bazuar në autoritetin që i është dhënë dhe në përputhje me përcaktimet e nenit 87 të Ligjit nr. 43/2015 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”, ERE përcakton kushtet e furnizimit nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE,

Vendosi:

1. Të fillojë procedurën për miratimin e “Rregullave për Kushtet e shërbimit të furnizimit me energji elektrike nga furnizuesi i mundësisë së fundit, dhe kushtet kontraktore të furnizimit”.
2. Deri në hyrjen në fuqi të këtyre rregullave Furnizimi si mundësi e fundit do të kryhet në të njëjtat kushte me shërbimin universal të furnizimit për aq sa është e zbatueshme.
3. Drejtoria Juridike dhe e Mbrojtjes së Konsumatorit të njoftojë të interesuarit për Vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim mund të ankimohet në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga botimi në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrit AHMETI